

**STATUT**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Bar Restorant Ferra” sh.p.k**

Me kete Statut, Ortaku:

- **Admirim Ferra**, dt.01.07.1970, lindur ne Shijak , banuese ne :Shijak, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes i kartes id nr.H00701002D

Dekalron te themeluar shoqerine **“Bar Restorant Ferra” sh.p.k**

**KREU I**

**FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZJATJA**

Neni 1

**FORMA**

I. Shoqeria eshte person juridik I formes “SH.P.K”.

II. Shoqeria eshte person juridik e krijuar ne baze te ligjit shqiptar ne fuqi

III..Aktivitetin ajo do ta zhvilloje sipas ketij Statuti,legjislacionit shqiptar tregetar dhe atij nderkombetar si dhe legjislacionit ter pergjithshem te aplikueshem ne fuqi

Neni 2

**EMERTIMI**

Emertimi Tregetar I Shoqerise ne tregun vendas dhe te huaj dhe ne mardhenie me te trete eshte :

**“Bar Restorant Ferra” sh.p.k**

Neni 3

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

I.Objekti I veprimtarise se Shoqerise eshte :

- Bar-restorant.Hotel.Plazh privat.

- Vandbazim per mjete ujore,motorrike dhe jo motorrike.
- Tregtim e prodhim te mallrave te te gjitha llojeve,industriale e ushqimore,import-exportin e tyre.Zenie e tregetim peshku.
- Ndertime civile.

Neni 4

**SELIA**

Selia e shoqerise caktohet ne : L13,rr. Lule bore,zk.8518,nr.39/195,Durres.

Neni 5

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise caktohet me afat te pa kufizuar.

**KREU II**

**KAPITALI FILLESTAR, KONTRIBUTET, PERGJEGJESIA, LEVIZJET E KAPITALIT,  
KUOTAT DHE KALIMI I TYRE.**

Neni 6

**KAPITALI**

Kapitali fillestar eshte **100.000 (njqindmije) leke.**

Neni 7

**PJESET E KAPITALIT**

- I. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 pjese
- II. Kontributet respektive te ortakeve :

- **Admirim Ferra 100,000 lëke, 100% te kapitalit**

Vlera e kontributit të ortakeve në kapitalin e shoqërisë do të depozitohet në bankë pas vendimit që Asambleja e ortakeve do të marrë për këtë qëllim dhe sipas procedurave që do të caktohen në këtë vendim.

Kur pjesët e kapitalit përqendrohen tek një person i vetëm (fizik ose juridik), shoqëria tregëtare vijon të funksionoj si shoqëri me ortak të vetëm dhe dispozitat e statutit gjejnë zbatim, për atë sa janë të përshatme dhe për ortakun e vetëm.

**Neni 8**

**KONTRIBUTET**

Kapitali themeltar dhe kontributet që përbejnë atë akordohen në para (lëke).

**Neni 9**

**PERGJEGJESIA**

- I. Shoqëria përgjigjet me aktivet e saj për detyrimet që mund të vijnë nga veprimtaritë e ushtruara.
- II. Ortaket nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë. Ortaket mbulojnë humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

**Neni 10**

**LEVIZJET E KAPITALIT**

- I. Në vijim të veprimtarisë kapitali i shoqërisë mund të jetë objekt ndryshimi – zmadhimi ose zvogelimi, me vendim të posaçëm të asamblese së ortakeve të shoqërisë.
- II. Ndryshimi i kapitalit bëhet nga asambleja e përgjithshme, e cila, merr vendime me shumicë të cilesuar.
- III. Zmadhimi i kapitalit nuk mund të bëhet, pa u shlyer plotësisht kontributet e nënshkruara më parë.
- IV. Ndryshimi i kapitalit nuk cenon të drejtat që rrjedhin nga kontributet me përparësi apo të drejtat që derivojnë nga kontributet në formë financimi për shoqërinë. Kontributet në formë financimi që mund të jepen shoqërisë nga ortaket nuk prodhojnë interesë.
- V. Shoqëria mund të marrë pjesë dhe të investoj kapital në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjta ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryej direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregëtare, financiare me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm. Shoqëria mund të hap dhe të mbajë llogari rjedhëse në lëke apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponoj lirisht mjete monetare të akumuluar në to, komfort legjislativ në fuqi.
- VI.

## Neni 11

### KUOTAT DHE KALIMI I TYRE

- I. Secili ortak gezon kuoten e tij ne shoqeri, te drejtat dhe detyrimet perkatese qe burojne nga zoterimi I kuotes, ne perpjestim me kontributin e dhene ne kapitalin e shoqerise.
- II. Kuotat dhe/ose pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Transferimi rregullohet sipas ketij statuti dhe vendimeve te asamblese se ortakeve per kete qellim.
- III. Ortaku qe deshiron te shese kuotat e tij jashte rrethit te ortakeve eshte I detyruar te njoftoj me shkrim ( leter rekomande) per kete qellim *shoqerine* dhe cdo *ortak individualisht*, duke bere te ditur kushtet e transferimit. Ne rast se, brenda 2 muajve nga data e marrjes efektive dijeni, ortakët nuk pergjigjen me shkrim per ushtimin e te drejtes se parablerjes, atehere miratimi I transferimit konsiderohet I dhene. Afati 2 mujor mund te shtyhet me vendim te zakonshem te asamblese, jo me shume se 10 dite, cdo here qe, njoftimi nuk permban detajimet e nevojshme per kushtet e transferimit. Ne rast se ortakët, brenda afatit 2 mujor, deklarojne se, do te ushtrojne te drejten e parablerjes, atehere, duhet te shlyejne brenda 30 diteve vleren e kuotave qe do te shiten. Afati 30 ditor fillon nga e vendimit per ushtimin e te drejtes se parablerjes. Nese ortakët nuk e shlyejne vleren e kuotave brenda afatit 30 ditor, e drejta e parablerjes shuhet.
- IV. Kalimi I kuotes dhe/ose pjeseve te kapitalit te te tretet jo ortak, nuk mund te behet ne kushte me te favorshme se ato qe I jane prezantuar ortakeve te shoqerise, ne te kundert ka vend per anullim te transferimit dhe sipas rastit shperblimin e demit.
- V. Kuota e shoqerise mund te zoterohet nga nje ortak I vetem ose ne bashkepronesi, ne menyre te barabarte ose jo. Ne rastin e kuotes qe zoterohet ne bashkepronesi, ne mardhenie me shoqerine dhe te drejten e votes, keta persona trajtohen si nje ortak I vetem dhe te drejtat I ushtrojne nga nje perfaqesues I perbashket
- VI. Transferimi I kuotes ne bashkepronesi, I nenshtrohet fillimisht te drejtes se parablerjes se bashkepronareve te kuotes, e nese keta refuzojne, ortakeve te tjere, pastaj te treteve, sipas rregullimit te bere ne piken V me larte
- VII. Ndalimet e percaktuara ne statut dhe rregullimet perkatese zbatohen edhe ne rastin e pjestimit te kuotave.

### KREU III

#### MARDHENIET E ORTAKEVE ME SHOQERINE, ASAMBJEA E ORTAKEVE, VENDIMARRJA

## Neni 12

#### MARDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

I. Per interesat e shoqerise, me vendim te posacem, asambleja e ortakeve mund te vendosi riinvestimin, ritjen e ezervave ose rikapitalizimin I fitimeve te realizuara nga viti financiar

II. Shoqeria ruan te drejten te pezulloje ose te anulloje kuoten e nje ortaku sa here qe egziston nje shkak I arsyeshem dhe I perligur

III. Vendimi per pezullimin / anulimin eshte I vlefshem kur vendosin te gjithë ortaket qe perfaqesojne kuotat e shoqerise, pa llogaritur ketu perqindjen e orakut per te cilin diskutohet anulimi

IV. Vendimi dhe kohezgjatja e pezullimit / anulimit duhet ti njoftohet ortakut perkates, I cili ka te drejten e ankimit ndaj vendimit te asamblese. Ankimi nuk pezullon vendimin e asamblese.

V. Asambleja percakton me vendim nese ka vend per shperblimin e demit

VI. Kuota e pezulluar / anuluar riperterihet nga asambleja me te rene shkaku, kur nje gje e tille pranohet nga shoqeria, ose me paraqitjen e vendimit te formes se prere te gjykates

VII. Statuti sanksionon parimin qe, ne rrethana te njejta, ortaket gezojne te njejtat te drejta, kane te njejtat detyrime proporcionale te trajtohen ne menyre te barabarte. Ky parim siguron mbrojtjen ne vazhdimesi te te gjithë te drejtave te ortakeve edhe atyre ne pakice kapitali. Eshte I pavlefshem cdo vendim qe ndryshon kete pike te nenit.

VIII. Ortaket dhe Administratorët jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, si dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjesore te tyre. Ata jane pergjegjes per pasojat e mundshme negative nga shkelja nga ana e tyre e sa me sipërthene. Detyrimi dhe pergjegjesia per sa eshte specifikuar ne kete nen, perfshine dhe Ekspertin Kontabel te Miratuar.

IX. Cdo ortak ne menyre te pavarur nga njeri tjetri,ka te drejte te hape llogari bankare ne emer te shoqerise. Per pagesat dhe terheqjet ,faturimet shtese dhe me te larta se 500 euro,duhet firma e te pakten dy antareve te cilet kane aksione ortakerie mbi 51%

## Neni 13

### ASAMBLEA E ORTAKEVE

I. Asambleja e pergjithsme eshte organi pergjegjes per marrjen e vendimeve per ceshtjet themelore, sic percaktohet ne nenin 81 te Ligjit tregetar

- II. Asamblea e pergjithsme mblidhet ne sesione te zakonshme te pakten nje here ne vi, e thirur nga administratori, kontabeli I miratuar, ortaket e shoqerise qe gezojne te pakten 5% te totalit te votave.
- III. Mbledhjet e asamblese organizohen ne seline e shoqerise, por kur egzistojne arsye objective apo ne varesi te ceshtjes konkrete, mbledhjet mund te mbahen ne nje vend tjeter.
- IV. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asamblese. Ne ushtimin e te drejtes per pjesmarje, cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter, ose nje person I trete I zgjedhur prej tij.
- V. Asamblea thirret nepermjet njoftimit me shkrese (dorazi, rekomande) ose nepermjet postes elektronike e ortakut (adrese e sakte e postes elektronike, ne funksion te thirrjes, do te konsiderohet adrese e depozituar ne shoqeri nga ortaku). Njoftimi permban vendin, daten, oren dhe rendin e dites. Per rastet kur konfirmohet rregullisht se nje ortak ndodhet jashte shtetit te territorit te vendit ku zhvillohet mbledhja, atehere afati I njoftimit dyfishohet.
- VI. Vendimet e marra ne kundersizim me percaktimin e rregullave te thirrjes jane te pavlefshme, vetem nese ortaket me unanimitet shprehen dakort pavarisist perregullsisse.
- VII. Ne shoqerine me nje ortak te vetem, funksionohet dhe atributet e asamblese ushtrohen nga ortaku I vetem
- VIII. Rastet e tjera qe kerkojne thirrjen e domosdoshme te asamblese se ortakeve do te konsiderohen ato te percaktuara ne nenin 82 te ligjit tregetar.

## Neni 14

### VENDIMARRJA

- I. Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice te zakonshme, shumice te cilesuar, dhe ne raste te vecanta me kuorum unanimit.
- II. Cdo ortak ka te drejte vote ne perpjestim me vleren niminale te kuotes se tij. Si rregull ortaket votojne ne menyre te hapur per ceshtjet rend dite, por ne rastet e vecanta me kerkesen e argumentuar te ortakut qe zoteron te pakten 10 % te votive, mund te aplikohet votimi I fshehte. Ushtrimi I te drejtes se votes per ortaket jot e pranishem ne asamble, behet shkrese e konfirmuar nga noteri, ose nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik : video koference , e- mail. Vota e derguar me e – mail eshte e vlefshme kur

dergohet nga adresa zyrtare e depozituar nga ortakut ne shoqeri me kushtin brenda afatit te votimit per ate ceshtje rend dite per te cilen ortakut voton .

- III. Vendimet e zakonshme do te konsiderohen te vlefshme per shoqerine kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortakut qe zoterojne me shume se 30% te kuotave,ne perputhje me nenin 86 te ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008”per tregetaret dhe shoqerite tregetare”.
- IV. Vendimet e cilesuara do te konsiderohen te vlefshme per shoqerine kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortakut qe zoterojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e numrit total te votive, dhe , vendimi merret nga nje shumice prej te pakten  $\frac{3}{4}$  e numrit total te votave
- V. Percaktimet e ketij neni korimin dhe vendimmarrjen nuk zbatohen per ato raste specifike kur ligji ose ky statut parashikojne ndryshe.
- VI. Nje ortak nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambeja shyrton ne rend dite dhe merr vendim per ndonje nga rastet e parashikuara ne nenin 89 te Ligjit tregetar. Ne keto raste, kuota e ortakut perkates nuk llogaritet ne perqindjen e kuorimit te nevojshem qe kerkohet nga statute.

#### KREU IV

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE, KESHILLI I PUNEMARRESVE

#### Neni 15

#### ADMINISTRATORI

- I. Administrator I shoqerise eshte personi fizik ortak ose jo ne shoqeri.
- II. Administratori emerohet me vendim te zakonshem statutor. Emerimi eshte I vlefshem ne rast se personi I zgjedhur me votim pranon emerimin e tij si administrator te shoqerise. Emerimi I administratorit behet me afat **5 vjet me te drejte ripertesitje**. Shkarkimi I administratorit behet me shumice te thjeshte ligjore (jo statutore) sipas nenit 86 / 1 dhe 95 / 6 te Ligjit tregetar/
- III. Administratori gezon kompetencat e parashikuara ne nenin 95 te ligjit tregetar dhe ato kompetenca te tjera te parashikuara ne nene te posacme te ketij ligji, apo qe lindin ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare.
- IV. Administratori mban detyrimet qe burojne nga ligjet ne fuqi, nga nenet 14-18, 95, 98 I Ligjit tregetar, por duke mos u kufizuar vetem ne keto nene te ligjit, nga statuti dhe vendimet e shoqerise si dhe nga parimet e mirebesimit, besnikerise, kujdesit dhe profesionalizimit. Administratori ndjek procedurat e njofimit te akteve te shoqerise ne

Institucionet Kompetente apo anasjelltas sipas rastit, perfaqeson shoqerine dhe leshon autorizime perfaqesimi per ceshte te natyrave specifike.

- V. Asamblea ka te drejte te marre ne shqyrtim veprimtarine e administratorit dhe/ose te procedoje per te ekzekutuar nje kerkim desmshperblimi ndaj tij. Vendimi perkates merret me shumice te zakonshme statutore.
- VI. Administratori detyrohet te demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara asaj nga veprimtaria e gabuar, parregullt, kundraligjshme, ne distancim te zgjeruar te politikave tregetare, etj.
- VII. Administratorit I takon rimbursimi I shpenzimeve te bera per arsye pune dhe/apo shperblime te vecanta, te cilat akordohen me vendim te zakonshem te shoqerise.
- VIII. Shoqeria mund te kete dy ose me shume administrator. Ne rast te administrimit me shume persona, shoqeria ne momentin e emerimit do te percaktoj me vendim tagrat e secilit dhe menyren e ushtrimit te funksioneve te administratorit. Administratori, ka te drejte qe, per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te shoqerise, te marre ne pune shtetas te ndryshem, duke lidhur kontrate sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi te miratuar me Ligjin Nr. 7961 dt 12.07.1995 dhe me Ligjin Nr. 7703, dt 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore" si dhe ne pershtatje me rregullat e brendshme te disciplines dhe te punes te percaktuara nga vete punedhenesi. **Administrator caktohet : z.Admirim Ferra**
- IX. Administratori perfaqeson shoqerine per veprime juridike apo financiare pa kufizime.

## Neni 16

### KESHILLI I PUNEMARRESVE

- I. Kur ligji parashikon detyimin e pranise se keshillit te punemarresve, keta te fundit kane te drejte te krijojne strukturat perkatese dhe rregulloret e brendshme te organizimit dhe funksionimit te tyre. Perfaqesuesi I keshillit te punemarresve nderton dhe shkemben informacion me perfaqesuesin ligjor te shoqerise per ceshtjet ne interest e tyre.

## KREU V

### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

## Neni 17

### LARGIMI I ORTAKUT

- I. Cdo ortak, per shkaqe te arsyeshme, mund te largohet nga shoqeria tregetare.



- II. Largimi behet duke njoftuar me shrim 90 dite perpara shoqerine, ku te jene permendur edhe shkaqet e largimit.
- III. Administratori therret mbledhjen e asamblese, e cila merr ne shqyrtim njoftimin e ortakut.
- IV. Vendimi I asamblese se zakonshme (shumice ligjore) qe pranon largimin e ortakut, percakton ose jo vleren e kompesimit te ortakut qe largohet. Edhe kur shkaqet e largimit konsiderohen te arsyeshme apo anasjelltas, asambleja sipas rastit mund te caktoje nje demshperblim ne ngarkim te ortakut

## Neni 18

### PERJASHTIMI I ORTAKU

- I. Asamblea e zakonshme (shumice ligjore) mund te kerkoje perjashtimin nga shoqeria te ortakut, kur ekzistojne shkaqe qe vleresohen te arsyeshme prej saj per kete perjashtim. Ne percaktimin e kuorimit te mbledhjes se asamblese per kete qellim, nuk perfshihet pjesa e ortakut per te cilin diskutohet perjashtimi. Kerkesa I drejtohet gjykates e cila vendos nese arsyet e pretenduara legjitmojne ose jo perjashtimin e ortakut.
- II. Shoqeria dhe ortakut kane te drejte ti kunderdrejtojne njeri-tjetrit pretendime per demshperblim  
Te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga cilesia e ortakut shuhen ne daten e largimit ose vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin.

## KREU VI

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

## Neni 19

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

- I. Cdo vit financiar fillon ne 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- II. Llogarite vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe sipas rastit nga kontabli I miratuar, duhet te miratohen nga asamblea me vendim te zakonshem.
- III. Cdo ortak ka te drejte te vihete ne dijeni per pasqyrat financiare dhe llogarite e shoqerise ne cdo kohe, nepermjet nje kerkesese te drejtuar administratorit 7 dite perpara.

## Neni 20

## DIVIDENTET

- I. Ortaket gezojne te drejten e terheqjes se fitimit te realizuar ne raport me kuotat e zoteruara.
- II. Pas miratimit te llogarive vjetore, Asamblea me vendim percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve apo/dhe shperndarjeve te mundshme. Asamblea, ne kete faze ose ne nje faze te mevonshme, por jo me larg se 3 muaj nga data e miratimit te llogarive vjetore, vlereson mundesine e aplikimit te parashikimeve qe vendos neni 12/1 I Statutit.
- III. Administratori siguron qe shperndarja e fitimit te kryhet ne respektim te kerkesave ligjore ne fuqi

## KREU VII

### BASHKIMI, NDARJA, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

#### Neni 21

### BASHKIMI, NDARJA, PRISHJA

- I. Shoqeria, me vendim te cilesuar te asamblese se ortakeve, mund te vendosi bashkimin apo ndarjen e shoqerise.
- II. Modalitet per realizimin e ketij veprimi percaktohen sipas rastit, gjithashtu, ne perputhje me urdherimet ligjore ne fuqi.

#### Neni 22

### LIKUIDIMI

- I. Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit ne momentin e prishjes se saj.
- II. Ne vendim, asamblea emerone nje ose disa likuidues, te cilet ndjekin hapat ligjore te likuidimit. Ne fund te procesit te likuidimit, asamblea, me shumice te zakonshme vendos miratimin e raportit te likuidimit, bilancit perfundimtar dhe gjithcka rreth procesit te likuidimit. Mbas pagimit te kreditoreve, likuiduesi dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar

## KREU VIII

### DISPOZITA TE FUNDIT

#### Neni 23

### MOSMARRVESHJET

- I. Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, etj, fillimisht do te shqyrtohen me ndermjetesim sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi Ligji nr. 10385, dt 24.02.2011 "Per zgjidhen e mosmarreveshjeve me ndermjetesim", ne te kundert mund t'i paraqiten per zgjidhje gjykates ku ka seline shoqeria.

Neni 24

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky Statut eshte hartuar ne 3 ekzemplare origjinale, duke patur te gjithë tekstet fuqi te barabarte Ligjore.

Durres,me 15.09.2020

Firmosur nga ortaku

Admirim Ferra

